



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna Dragash / Opština Dragas**

---

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja f) dhe p) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008) nenit 15. Paragrafi 7. I Ligjit për mbeturinat ,Nr.04/L-060 dhe nenit 32.2. të Statutit të Komunës së Dragashit 01 nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi Komunës së Dragashit, në seancën e rregullt të mbajtur më 31.06.2016, miraton këtë:

**R R E G U L L O R E**  
**PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE**

**Neni 1.**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është pastrimi i ambientit në territorin e komunës nga të gjitha llojet e mbeturinave si dhe menaxhimi i tyre nga qytetarët dhe institucionet kompetente të komunës së Dragashit.

**Neni 2.**  
**Fusha e zbatimit**

1. Me këtë rregullore përcaktohen:
  - 1.1. përgjegjësit dhe detyrimet e organeve komunale dhe të qytetarëve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, caktohen tarifat dhe mënyrat e inkasimit të mjeteve financiare për të gjithë personat fizik dhe juridik.
  - 1.2. Me rregullore rregullohen edhe të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave.

**Neni 3.**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet- fjalët që përdoren në këtë rregullore, kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **Mbeturinë:** objekt që prodhuesit apo qytetari e hedhë si send i pa përdorshëm në veprimtari.
  - 1.2. **Mbeturinat nga i objektet ndërtimore (këtu e tutje ND) - nënkuptojnë:** mbeturinat të cilat krijohen gjatë ndërtimit, rindërtimit, renovimit, demolimit ose

shkatërrimit të objektit e të cilat konsiderohen si : gurë natyror Bllok,beton, drurë , plastik , qelq, metale e të ngjashme.

**1.3. menaxhimi i mbeturinave:** procesin fizik, kimik, biologjik, termal duke përfshirë ndarjen e mbeturinave në lloje me qëllim të zvogëlimit të sasisë dhe lehtësimin për riciklim.

**1.4. Riciklim :** përpunimi i mbeturinave dhe rikthimi i tyre në produkte, materiale e substanca të ndryshme.

**1.5. Gjenerues- prodhuesi i mbeturinave:** Çdo person i cili nga puna e vet krijon mbeturina të cilat ndikojnë në ndryshimin apo në ndotjen e ambientit.

**1.6. Bio-mbeturinat :** mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet,ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet , restorantet, objektet turistike , shitoret me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet për përpunimin e mishit.

**1.7. Hapësira publike –** Të gjitha vendet të cilat shfrytëzohen në mënyrë të ligjshme nga të gjithë qytetarët.

**1.8. Deponi –** Vendi i caktuar ku grumbullohen mbeturinat e qytetit.

**1.9. Kompostimi:** Trajtimi i mbeturinave bio-degraduse nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushtet e kontrolluara.

**1.10. Zotëruesi i mbeturinave –** Prodhuesi i mbeturinës apo personi që posedon mbeturina.

#### **Neni 4.**

#### **Ndalesat dhe kufizimet**

**1.** Gjeneruesve të mbeturinave ju ndalohe:

**1.1.** Djegia e mbeturinave në vende të hapura

**1.2.** Djegia e mbeturinave të cilat me sasinë e tyre i tejkalojnë vlerat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi,

**1.3.** deponimin derdhjen apo shkarkimin e mbeturinave biodegraduese në vende publike dhe private ,këtu përfshirë rrugët, vend parkimet dhe të gjitha vendet publike dhe pasurit private arat , livadhet, malet dhe paluajtshmerit tjera.

**1.4.** varrosjen shtazëve dhe shpenzove në vendet afër burimeve të ujërave, në hapësirat publike, vendbanimeve dhe ujera sipërfaqësor në largësi prej 1000 metra.

**1.5.** Gjuajtjen e shtazëve dhe shpezëve në proçka dhe lumenj,

**1.6.** Trajtimi i mbeturinave nga personat apo kompanitë e pa licencuara për menaxhimin e mbeturinave

**1.7.** deponimin e mbeturinave të stallave në të cilën ruhen kafshët (plehu) në vende publike.

**1.8.** deponimin e mbeturinave të drurit në djeponit e mbeturinave

**1.9.** Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje dhe qytetarët

**1.10.** Përzieja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontinjerëve, shportave të destinuara për ndarjen e mbeturinave të ricikluara.

**1.11.** Hedhja e mbeturinave jashtë kontinjerëve,



**1.12.** Shfrytëzimi i kontinjerëve – shportave publike nga bizneset ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin e mbeturinave komunale e komerciale.

## **Neni 5.**

### **Pastrimi dhe bartja e mbeturinave**

**1.** Grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave e bënë ndërmarrja ose personi i licencuar për menaxhimin e mbeturinave.

**1.1** Bartja e mbeturinave bëhet ditën dhe natën. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten duhet patjetër të jenë të mbyllura ose të mbuluara, ashtu që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit në deponinë e caktuar.

**1.2.** Orarin për bartjen e mbeturinave e cakton Drejtoria komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

## **Neni 6.**

### **Grumbullimi i mbeturinave në hapësira publike**

**1.** Për grumbullimin e mbeturinave në hapësirat publike, shfrytëzuesit e vendeve publike sigurojnë dhe vendosin shporta dhe kontinjer për grumbullimin e mbeturinave.

**1.1.** Vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave dhe kontinjerëve është obligim i ndërmarrjes kontraktuese për mirëmbajtjen e higjienës publike

**1.2.** Drejtoria komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike në vende publike, cakton vendin ku do të vendosen kontinjerët, shportat dhe mjetet tjera, numrin e tyre dhe madhësinë.

**1.3.** Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e banimit kolektiv dhe llojin e mbeturinave që krijojnë.

**2.** Mbledhja e mbeturinave nga hapësira për rreth banesave dhe lokaleve afariste bëhet me enë speciale

**2.1.** Vendi dhe mënyra e enëve speciale caktohet nga Drejtoria komunale për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime publike në bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

**3.** Ndërmarrje ,dyqane afariste dhe qytetarët janë të obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojnë dhe të kenë numër të mjaftueshëm të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësirat e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira rreth tyre.

**3.1** Sigurimin dhe vendosjen e enëve-mjeteve speciale ,obliguesit janë të detyruar që të bëjnë në afat prej 2. Muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.

**3.2.** Të gjitha mbeturinat e mbledhura nëpër shporta, kontinjerë dhe enë speciale do të transportohen në deponin e qytetit.

**4.** Spitalet, ambulancat dhe objektet tjera për shërbime mjekësore duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale nga ato komunale.

**Neni 7.**  
**Transportimi i mbeturinave**

**1.** Bartjen e të gjitha mbeturinave e kryen Ndërmarrja kontraktuese së cilës i besohen punët e bartjes dhe pastrimit.

**1.2.** Ndërmarrja kontraktuese e cila bënë mirëmbajtjen e higjienës së qytetit ,është e obliguar që ti përmbahet Planit dhe Programit të miratuar nga Kuvendi komunal i komunës së Dragashit.

**1.3.** Plani dhe programi për menaxhimin e mbeturinave mund të ndryshohet me pëlqimin e të dy palëve, komunës dhe ndërmarrjes.

**Neni 8.**  
**Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore(ND)**

**1.** Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, personat duhet t'i largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë.

**1.1..**Mbeturinat nga ND pas dorëzimit të tyre nga prodhuesi , duhet të jenë në menaxhim të operatorit licencuar nga MMPH-ja dhe të kontraktuar nga komuna.

**1.2.** Transportimi i këtyre mbeturinave bëhet nga personat që janë të licencuar për bartje dhe menaxhim , ose nga vetë prodhuesit, për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në deponitë e caktuara nga Komuna.

**Neni 9.**  
**Trajtimi dhe deponimi i mbeturinave**

**1.** Komuna është e obliguar që për grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave të ND të caktoj qendrat e caktuara si:

**1.1.** gropa prej nga është nxjerr guri,dheu ose rëra;

**1.2.** hendeqe të krijuara në mënyrë natyrale;

**1.3.** vende të degraduara nga shembjet ose rrëshqitjet e dheut;

**1.4.** përroska apo kanale të degraduara nga erozioni të reshurave atmosferike dhe

**1.5.** hapësira tjera të zbuluara për bazamente të objekteve ndërtimore.



2. Për ndërtimin i qendrave për grumbullimin e mbeturinave të ND dhe deponive për menaxhimin e mbeturinave nga MD , komuna e Dragashit nuk duhet të pajiset me pëlqim mjedisor sepse ka ma pak se 60000 banor.

### **Neni 10.**

#### **Financimi**

Shpenzimet për largimin e mbeturinave nga hapësirat publike mbulohen nga taksat e mbledhura për kryerjen e shërbimeve të pastrimit dhe buxheti i komunës sipas kritereve të përcaktuara nga komuna.

### **Neni 11.**

#### **Tarifat**

Tarifat për largimin trajtimin dhe deponimin e mbeturinave të ND i cakton komuna.

### **Neni 12.**

#### **Përgjegjësit e komunës për menaxhimin e mbeturinave**

1. Përgjegjësit e komunës për menaxhimin e mbeturinave janë:
  - 1.1. të organizoj sistemin për klasifikimin e mbeturinave,
  - 1.2. të inkurajoj dhe të stimuloj biznesin që të merret me trajtimin të mbeturinave për përfitim të kompostit apo energjisë elektrike,
  - 1.3. të stimuloj përdorimin e teknikave , pasjeve dhe metodave ma të mira për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave,
  - 1.4. të mbikëqyrë dhe inspektoj në vazhdimësi operatorët që menaxhojnë mbeturinat, përmes inspektorit komunal për mjedis.
  - 1.5. të hartoj Planin dhe Programin komunal për menaxhimin e mbeturinave në harmoni me aktet Ligjore dhe nënligjore,
  - 1.6. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë në harmoni me Planin nacional,
  - 1.7. të hartoj Raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave, raporti vjetor i hartuar dhe i miratuar nga Kuvendi duhet dorëzuar në Ministri, deri më 31. mars të vitit vijues.
  - 1.8. komuna përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në bazë dispozitave të Ligjit për prokurimin,
  - 1.9. evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e komunës, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin , karakteristikat hapësinore.
  - 1.10. caktimi i tarifës dhe mënyrës së inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale.
  - 1.11. Planifikim buxhetor për funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.

**Neni 13.**  
**Caktimi i lartësisë së kompensimit**

Tarifën për lartësinë e kompensimit e cakton Komuna si në shtojcën e kësaj Rregullore.

1. Komuna përcakton mënyrën dhe formën e caktimit të tarifës për mbeturina me Rregullore të veçantë për tarifa dhe ngarkesa,
2. Komuna dhe organet kompetente përkatëse përcaktojnë mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave komunale.

**Neni 14.**  
**Përgjegjësit dhe detyrimet e zotuesit të mbeturinave**

1. Gjeneruesit- zotuesit e mbeturinave veprimtarin e vet ta ushtroj në harmoni me Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave,
  - 1.1. Zotuesit e mbeturinave është i detyruar që gjatë punës së vetë të gjeneroj sa ma pak mbeturina,
  - 1.2. gjeneruesit e mbeturinave për shërbimet e ofruara për menaxhim të mbeturinave janë të obliguar të paguajnë shërbimet sipas tarifës së caktuar me këtë Rregullore.
  - 1.3. Gjeneruesit e mbeturinave me sasi të mëdha, janë të obliguar për të përgatisin Planin për Menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 15.**  
**Të drejtat e zotuesve të mbeturinave.**

1. Çdo gjenerues duhet të bashkëpunoj me institucionet komunale, ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave,
2. Gjeneruesit e mbeturinave kanë të drejtë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.
3. Për shërbimet e ofruar në kundërshtim me këtë Rregullore ,zotuesit kanë të drejtë ankese tek organet komunale kompetente për këtë çështje – Drejtoria komunale për Shërbime publike

**Neni 16.**  
**Kompostimi i mbeturinave**

Mbeturinat biodegraduese të cilat mund të kompostohen janë: mbeturinat nga përpunimi i drurit, plehu organik nga shtallat e fermave të shtazëve dhe shpezëve e mbeturinat nga amvisnit, tregjet, restorantet, kopshtet dhe industria ushqimore.

**Neni 17.**  
**Mbeturinat të cilat nuk kompostohen**

Mbeturinat organike biodegraduese të cilat nuk duhet të kompostohen janë: organet e brendshme dhe eshtrat e kafshëve si dhe të gjitha bimët që janë prekur nga sëmundjet e ndryshme dhe mbeturinat e spërkatura me helme për mbrojtjen e bimëve.

**Neni 18.**  
**Raportimi për menaxhimin e mbeturinave**

1. Raporti për menaxhimin e mbeturinave hartohet në çdo vit dhe prezantohet tek organi mbikëqyrës në tremujorin e par të viti vijues.

2. Zotëruesit dhe prodhuesi e mbeturinave përveç të amvisinive ,janë të detyruar të paraqesin raport vjetor deri më 31. Marsit vitit vijues.

3. Personat e licencuar që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin raport vjetor deri më 31. Mars të vitit vijues. Raporti nga personat e licencuar paraqitet në Komunë .

4. Raportuesit në raportet e tyre me shkrim duhet të paraqesin të dhënat:

4.1. llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin, dhe deponimin e mbeturinave dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave.

4.2. çështjet tjera të rëndësishme për menaxhimin e mbeturinave.

**Neni 19.**  
**Dispozitat ndëshkuese**

1. Të gjithë personat të cilët nuk i zbatojnë dispozitat e kësaj Rregullore do të ndëshkohen në bazë të dispozitave të Ligjit për Mbeturinat.

1.1. Ndaj gjeneruesve të mbeturinave të cilën kundërshtojnë pa arsye pagesën e tarifës për shërbimet e ofruara, do të inicohet procedura gjyqësore në gjykatën kompetente.



**Neni 20.**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

**1.** Për rastet e pa rregulluara në këtë Rregullore , për rregullimin tyre mundë të zbatohet Ligji për Mbeturinat.

**1.1.** Për zbatimin e kësaj Rregullore përkujdesen : Kryetari i komunës së Dragashit dhe Drejtoria komunale për Shërbime Publike në Dragash.

**Neni 21.**  
**Shtojca e Rregullores**

Kjo rregullore si shtojcë do ta ketë dokumentin për caktimin e lartësisë së tarifës së taksës për mbeturina.

**Neni 22.**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15. ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e APL, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.

**01 Nr.06-8491/2**

**Dt.31.05.2016**

**D r a g a s h**

**KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL**  
  
**Shaban Shabani**





+  
**Shtojca 1. Tarifat e taksave për mbeturina**

**1. Amvisnit :**

1.1. Zonat Urbane ..... 4.50€

1.2. Zonat Rurale ..... 4.50€

*Vrejtje: në shuma të caktuara është llogaritur edhe tvsh*

**2. Tarifat e taksës së mbeturinave do të caktohet në bazë të hapësirës së objektit në m2dhe atë :**

1.1.Bizneset me hapësira prej 1 – 20m2 ..... 5.20 €

1.2.Bizneset me hapësirë prej : 21 – 50m2..... 12.15 €

1.3.Bizneset me hapësirë prej : mbi 50m2..... 20.50 €

**3. Tarifa minimale për institucionet publike dhe bizneset ma të zhvilluara të bëhen-të caktohen me kontraktim individual me ofruesin e shërbimit.**

1.1.Kostoja e kontejnerit ..... 1m3 ..... 11.30 € - Zbrazje

1.2.Kostoja e kontejnerit ..... 7m3 ..... 44.70 € - Zbrazje

**4. Tarifa minimale për shkolla**

Në shkolla tarifat caktohen në bazë të nxënësve dhe punëtorëve të shkollave  
**1m2..... 0.15.€**

**5. Tarifat minimale për pastrim të qytetit caktohen sipas m2: 1m2.....015€**